

Kujdesi Plus

Projekti rreth kujdesit të shoqërisë (të moshuarit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara) përmes shërbimeve në furnizimin me ushqim, kujdes shëndetësor dhe aktivitete fizike.

Problemi

Shkaku i emigrimit në diasporë dhe migrimeve tjera të popullatës, nevoja për përkujdesjen e të moshuarve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara në fshatin Brezne sikurse në të gjitha trevat e Kosovës, është përkeqësuar dhe nevoja për një organizim më të mirë është shumë e madhe.

Problemet e tilla janë të shfaqura pothuajse në të gjitha grupet e shoqërisë por nevojat më të mëdha janë tek personat që jetojnë vetëm dhe ata të cilët familjet i kanë në diasporë.

Zgjidhja

Startup-i apo ndërmarrja “ALBNORD” është duke zhvilluar një model të organizimit duke u bazuar në përvojat e shteteve Nordike (Finlandë, Suedi, Norvegji dhe Danimarkë) si dhe duke e kombinuar edhe me sistemi e trojeve shqiptare me qëllim të funksionimit sa më të lehtë.

Disa pika kryesore rreth zgjidhjes së këtij problemi:

1. Menaxhimi do bëhet përmes një sistemi digjital si dhe qendra që do ketë bazën në Dragash dhe me vonë do shtohen sipas nevojës
2. Furnizimi me mjetet e nevojshme, ushqim dhe gjërat tjera do bëhet nga grupet e caktuara duke bërë marrëveshje të bazuara në kontrata sipas ligjeve në Kosovë si dhe ligjeve në shtetet ku vepron ndërmarrja (Vendet gjermano-folëse dhe Nordike)
3. Pasi kjo është ndërmarrje private, çdo kush që punon apo jep mundin në forma tjera, do të shpërblehet në bazë të marrëveshjes dhe rregulla që parashihen me ligj
4. I gjithë procesi do mbikëqyret nga një grup i caktuar duke përfshirë edhe diasporën
5. Organizimi do bëhet në grupe duke u ndarë;
 - a. Furnizimi me ushqim përmes një 1-2 pikave në fshat (mund të jenë edhe lokalet që operojnë) dhe gjithashtu shpërndarja tek secili në shtëpi (sipas nevojës)
 - b. Grupi ku përfshihet mjeku, infermieri si dhe stafi për aktivitete
 - c. Administrata që do merret me çështjet administrative, komunikimin dhe gjërat tjera organizative
6. Informacionet shtesë rreth të gjitha gjërave tjera, do i publikojmë sapo të arrihet aksioni i parë dhe kohë pas kohe do shtojmë materiale shtesë

Tregu

Sa i përket tregut, nevoja është shumë e madhe në të gjithë trojet shqiptare por ne do fillojmë së pari në fshatin Brezne dhe pastaj do të zgjerohemi edhe në fshatrat tjera të komunës së Dragashit dhe në fazën e tretë projekti do zgjerohet edhe në trevat tjera të Kosovës

Konkurenca

Sa i përket konkurrencës, për momentin në fshatin Brezne nuk ka shërbime të tilla por me duket edhe në komunën e Dragashit në një nivel të tillë nuk ka ndërsa në disa treva tjera apo qytete, ekzistojnë disa shërbime por janë më ndryshme. Kjo çështje nuk është primare për momentin.

Modeli i biznesit

Si për fillim modeli i biznesit do fokusohet vetëm në dy grupe a) B2C dhe b) B2G. Në vazhdim një përshkrim shumë i shkurt përndryshe këto pika do sqarohen shumë në detaje.

- a) B2C – Biznes me konsumator
Kjo ka kuptimin e një shërbimi kur konsumatori apo klienti blen një shërbim nga një ndërmarrje private – biznes d.m.th ndërmarrja “Kujdesi Plus” do ketë paketat rreth shërbimeve për kujdesin që ne do ofrojmë
- b) B2G – Biznes me qeveri
Kjo ka kuptimin e një shërbimi kur organet qeveritare (lokale apo qendrore) blejnë apo përkrahin shërbimin për furnizimin e një shërbimi të caktuar dhe në këtë rast disave pagesën do ja mbulon qeveria

Ekipi

Në fillim do ketë një ekip të vogël shkaku i procesit të zhvillimit dhe zgjerimit dhe do ndahet në disa grupe.

- a) Udhëheqësi apo koordinator i këtij projekti Faton Krasniqi
- b) Furnizimi me ushqim në fillim do blihet nga një xhellore apo nëse ka vullnet dikush mund të krijojë një grup dhe sigurisht gjithçka do të paguhet
- c) Mjeku dhe infermieri do punojnë sipas nevojave në fillim derisa të zgjerohemi
- d) Aktivitetet fizike do fillojnë në Pranverë (më shumë informacione do vijnë më vonë)
- e) Administrata dhe menaxhimi do bëhen në koordinim me qendrën
- f) Qendrat kryesore do jenë në Dragash dhe me vonë do hapet edhe në Prishtinë si dhe vende tjera sipas nevojës
- g) ALBNORD d.m.th startupi që jam duke zhvilluar do mbikëqyr procesin e zhvillimit derisa të arrihet një nivel i mirë i menaxhimit dhe do jetë projektuesi i gjithë procesit
- h) ALBNORD do sjell edhe investime shtesë në fazën e dytë që mund të ndodh vitin tjetër

Investimi

Kjo është ndër pikat kryesore që duhet mu sqaru në detaje dhe mundet me marrë kohë, ndoshta edhe 1 vit por procesi i fillimit të veprimtarive nuk ka nevojë me prit shumë pasi aksionet e para, që mund ti quajmë edhe testuese mund të fillojnë shumë shpejt dhe nevoja e investimeve në fillim është e vogël.

Për momentin po i jap vetëm disa pika por duhet të keni parasysh, ata që kanë interes me qenë pjesë e investimeve, do marrin shumë informacione në detaje d.m.th për gjithçka do jepen detaje duke u bazuar në ligjet e Kosovës dhe gjithashtu ligjet e shteteve të Evropës pasi investitorët mund të jenë nga shtete të ndryshme.

Disa pika kryesore që do përfshihen

- a) Ndërmarrje do jetë e formës publike apo Sh.P.K – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (modeli me shumë aksionarë, në Gjermanisht i thonë GmbH)
- b) Fillimi i veprimtarive do jetë në formën e startup-it, sigurisht duke ju përmbajtur rregulloreve dhe përafërsisht pas 1 viti kalon në ndërmarrje publike si Sh.P.K
- c) Investimi do ketë modelin standard që përdoret në tërë botën d.m.th quhet PreeSeed (Sqarimet në detaje do vijnë edhe në gjuhën shqipe sepse e kam parasysh që për shumicën mund të jenë gjëra të reja por besoj të gjitha sqarohen me kohën)
- d) Investimi fillestar do varet se sa ka interes d.m.th nëse interesi në fillim është i mjaftueshëm atëherë edhe investimet tjera do tërhiqen shumë më lehtë
- e) Kapitali fillestar duhet të jetë së paku 10 000 € dhe pastaj në bazë të shërbimeve do rritet
- f) Kapitali i përgjithshëm, vlerësimi i aksioneve dhe gjërave tjera, do bëhet gjatë procesit të zhvillimit që mund të zgjat deri në 1 vit apo më saktë gjatë pushimeve të ardhshme, gjithçka do jetë gati

Grupet si investitor

Pasi që projekti apo startup-i do ketë një shtrirje të gjerë edhe në grupin e investitorëve do përfshihen;

- a) Personat privat (nga të gjitha shtetet)
- b) Ndërmarrjet private (Trojet shqiptare dhe disa shtete të Evropës)
- c) Qeveria e Kosovës
- d) VC – Venture Capitals apo ndryshe quhen firmat private që bëjnë investime apo blejnë aksione nëpër ndërmarrje

Brezne

Informacione shtesë rreth investitorëve me prejardhje nga fshati Brezne

Pasi fillimi testues do jetë në fshatin Brezne edhe investimet e parë sigurisht do kenë përparësi sepse investimet do kalojnë në disa faza dhe secila fazë që kalon një shkallë më lartë, vlera e investimit në kapital rritet. Këto sqarime do bëhen edhe në gjuhën shqipe.

Kontakt

Për të gjithë të interesuarit, mund të më shkruani në e-mail apo e keni edhe nr e telefonit në Whatsapp. Më lehtë më vjen nëse më shkruani dhe sipas nevojës edhe flasim në tel.

Disa pyetje të përgjithshme, në fillim i bëj tek grupi dhe më vonë do krijohen grupet që i përkasin vetëm këtij projekti dhe qasje do kenë vetëm ata që bëhen pjesë e këtij startup-i.

Me respekt,

Faton Krasniqi

+358 40 837 4680

fatonmedia@gmail.com

www.albnord.com

Helsinki / Finlandë